



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO

MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTARSTVO ODBRANE-MINISTRY OF DEFENSE

— PLANI — I INTEGRITETIT (2019-2022)

KORRIK, 2019

Grupi punues për hartim:

A7 Faruk GECI-MM
A6 Arben GASHI-MM
OF5 Sefer ISUFI-KFT
OF4 Bekim ZEJNULLAHU-MM
OF4 Binak ZEKAJ-MM
A4 Ismet MECINAJ-MM
OF4 Mentor ZEJNULLAHU-MM
OF4 Remzije MORINA-MM
OF4 Lulzim DELIU-MM
Dr Florian QEHAJA-CIDS
Afrim ATASHI-AKK
Arife KODRALIU-MAP
OF4 Henrik KROGH-NALT
Klemen STIBELJ-NALT

Zhvillimi i Planit të Integritetit është mbështetur nga Mbretëria e Norvegjisë si asistencë dhënë Republikës së Kosovës, e cila u bë në kuadër të projektit “Ndërtimi i Integritetit në Ballkanin Perëndimor”. Mbështetja është dhënë nga Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes (CIDS) e cila mbledhi ekspertë norvegjezë, rajonalë e vendorë të fushës.

— PLANI —
I INTEGRITETIT
(2019-2022)

Përmbajtja

Parathënie	5
Shkurtesat	6
Hyrje.....	7
Shkalla e zbatimit të Planit të Integritetit (2016-2018).....	9
Qëllimi	10
Parimet	10
Metodologjia	10
Procesi i përpilimit	12
Objektivat strategjike 2019-2022	12
1. Avancimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore	13
2. Parandalimi i konfliktit të interesit	15
3. Avancimi i sistemit të prokurimit dhe kontraktimit	16
4. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve materiale, financiare dhe aseteve.....	17
5. Fuqizimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm	18
Matrica e masave dhe aktiviteteve për zbatimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes (2019-2022)	20

Parathënie

Integriteti është ndër vlerat më të larta morale njerëzore si në aspektin individual ashtu edhe atë organizativ. Cilësia e të qenit "i ndershëm" nënkupton posedimin e parimeve të forta morale që i adresohet çdo individ. Kjo vlerë, edhe në aspektin institucional, është trajtuar dhe adresuar në nivel shumë të lartë në mekanizmat e lidhshëm të procesit udhëheqës dhe menaxhues në të gjitha strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës. Pra, ndër objektivat kryesorë të Ministrisë dhe Forcës, që nga themelimi dhe gjatë gjithë fazës parapërgatitore për tranzicion në misionin ushtarak ka qenë promovimi i qeverisjes së mirë dhe synimi për zbatimin e parimeve të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies, në përputhje me normat dhe praktikatat ndërkombëtare.

Ne, Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, në kuadër të vizionit tonë afatgjatë, synim qendror kemi ndërtimin dhe funksionalitetin e mekanizmave tanë institucionalë si dhe zhvillimin e politikave në përputhshmëri të plotë me ato të NATO-s, me qëllim që në kohën e duhur kur të aderojmë qoftë në Programin e Partneritetit për Paqe, qoftë si anëtare e saj, të jemi gati për ndërveprueshmëri të plotë. NATO i ka dhënë vend të posaçëm zhvillimit të strategjive, planeve dhe programeve me qëllim të kultivimit dhe fuqizimit të integritetit në kuadër të strukturës së saj organizative. Programi i saj për ndërtimin e integritetit në institucionet e mbrojtjes dhe sigurisë tanimë është politikë e obligueshme, e cila zbatohet nga të gjitha vendet anëtare dhe partnere të saj.

Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja, tash e disa vite në të gjitha sondazhet më kredibile të vendit, janë institucionet me besueshmërinë më të lartë qytetare. Ky vlerësim sa na bën nder, aq na e shton edhe përgjegjësinë që politikatat kundër dukurive negative dhe dukurive tjera joetike t'i avancojmë në stadin e strukturuar si standard i punës sonë menaxhuese, administrative dhe operacionale në të gjitha nivelet e funksionimit të Ministrisë dhe Forcës. Mekanizmave tanë të strukturuar dhe funksionalë të menaxhimit të burimeve njerëzore, materiale dhe financiare, si dhe mekanizmave të funksionimit të kontrolleve të brendshme, sikur edhe në trevjetëshin e kaluar, i bashkëngjisim edicionin e ri të Planit të Integritetit 2019-2022, respektivisht mekanizmat për implementimin e tij.


Plani ynë i Integritetit është një mjet për krijimin dhe verifikimin e integritetit të institucionit tonë. Ai reflekton një proces të dokumentuar për vlerësimin e nivelit të ndjeshmërisë së organizatës sonë, ekspozimit të saj ndaj praktikave joetike dhe korruptive. Qëllimi kryesor i Planit të Integritetit është forcimi i integritetit dhe kulturës kundërkorrupsion në sektorin publik duke identifikuar rreziqet, planifikimin dhe zbatimin e masave adekuate. Vendosja e një sistemi të përgjithshëm kundërkorrupsion, krahas planit të integritetit, do të rezultojë në forcimin e sundimit të ligjit dhe besimit të njerëzve në institucione. Me hartimin e këtij plani, Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja, vazhdojnë të jenë anëtarë dinjitozë në grupin e madh të vendeve të cilat kanë zhvilluar ose janë në proces të zhvillimit të strategjisë së ngjashme dhe njëkohësisht janë dhe do të jenë model për dikasteret, agjencitë dhe organizatat tjera qeveritare vendore për politiken përkatëse.

Në fund, dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për Grupin Punues për angazhimin e tij në hartimin e Planit përkatës. Njëherësh shpreh falënderim të posaçëm për Qendrën për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes (CIDS) të Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Norvegjisë për mbështetjen e gjithanshme në realizimin e këtij projekti në vazhden e politikave për përmbushjen e njërit prej prioriteteve kryesore të Programit qeverisës të Republikës së Kosovës dhe Planit ministror të Ministrisë së Mbrojtjes në procesin e tranzicionit. Unë kam besim të plotë se kemi kapacitete profesionale dhe se të gjithë zyrtarët dhe oficerët përgjegjës për implementimin e Planit përkatës do të bëjnë punën e duhur me moton: "Për Ministri dhe Forcë me integritet të duhur".

Ju faleminderit!

Z. Rrustem Berisha

Ministër i Mbrojtjes



Shkurtesat

AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
BE	Bashkimi Evropian
CIDS	Centre for Integrity in the Defence Sector
DBS	Departamenti për Bashkëpunim dhe Siguri
DFIN	Departamenti i Financave
Difi	Difi – the Agency for Public Management and e-Government
DIS	Departamenti i Inteligjencës dhe Sigurisë
DK	Departamenti i Komunikimit
DLIGJ	Departamenti Ligjor
DLOG	Departamenti i Logjistikës
DOT	Departamenti i Operacioneve dhe Trajnimeve
DPER	Departamenti i Personelit
DPROK	Departamenti i Prokurimit dhe Kontratave
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
INSP	Inspektorati i FSK-së
KE	Këshilli i Evropës
KFT	Komanda e Forcave Tokësore
KRPP	Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MAP	Ministria e Administratës Publike
MBNJ	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MM	Ministria e Mbrojtjes
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NALT	NATO Advisory and Liaison Team
NATO	The North Atlantic Treaty Organization
NI	Ndërtimi i Integritetit
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJMSHP	Njësia e Mbështetjes me Shërbime të Përgjithshme
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
PAP-DIB	Partnership Action Plan on Defence Institution Building

Hyrje

Ndërtimi i integritetit institucional vazhdon të mbetet një ndër aspektet më të rëndësishme në procesin e shtetndërtimit. Mungesa e investimeve në integritet mund të rezultojë në institucione publike dhe zyrtarë të ekspozuar ndaj veprimeve negative, duke rezultuar kështu në keqpërdorimin e fondëve publike dhe keqmenaxhimin e sistemit institucional. Krahas implikimeve në buxhet, dukuritë negative mund të paraqiten edhe në rastet tjera, p.sh. nëse sistemi i jo-meritës është shfaqur në sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore apo edhe kur kemi reflektim të konfliktit të interesit. Pra, dukuritë negative nuk duhen parë vetëm nga aspekti monetar por edhe nga një kontekst më i gjerë i veprimeve ose mosveprimeve të cilat nënçmojnë vlerat demokratike si dhe sundimin e ligjit. Koncepti i integritetit, edhe pse i zbërthyer në nivele të ndryshme, më së miri i përgjigjet perkufizimi i cili e kornizon integritetin si “veprime të zyrtarëve për të kryer punët mirë edhe atëherë kur ata nuk janë nën mbikëqyrje.”

Republika e Kosovës dhe institucionet e saj janë të zotuar edhe para institucioneve ndërkombëtare, ku synon të aderojë, se do të zbatojë fuqishëm integritetin institucional si koncept, politikë dhe praktikë të integruar plotësisht në punën e tyre të përditshme. Këtë aspekt tejet të rëndësishëm, Republika e Kosovës e ka dëshmuar edhe më herët me politika të veçanta siç është duke e trajtuar edhe tani me strategji të veçantë kombëtare si me Strategjinë Kombëtare Kundër Korrupsionit (2019-2022).

Në këtë aspekt, ngritja e kapaciteteve të mbrojtjes kërkon masa specifike të mbikëqyrjes për ndërtimin e integritetit për shkak të natyrës së informacioneve të klasifikuara që posedon ky institucion, por edhe për shkak të blerjeve të pajisjeve me vlera të mëdha. Në fakt, çështjet e sigurisë nacionale nuk duhet të fusin nën hije masat e llogaridhënies të cilat kërkojnë, para së gjithash, ngritjen e integritetit. Edhe në shtetet demokratike, sektori i mbrojtjes kategorizohet në radhët e institucioneve të “dyshimta” për shkak të praktikave politike e administrative të cilat dërgojnë në keqpërdorim të pushtetit dhe nganjëherë edhe bashkëveprim me krimin e organizuar duke e bërë këtë sektor jo-imun ndaj sjelljeve korruptive.

MM-ja dhe FSK-ja, përkundër faktit se çështjen e integritetit e kanë renditur edhe në akte normative, të trajtuar edhe në dispozitë të veçantë brenda Kodit të Etikës si një ndër vlerat dhe standardet kyçe të funksionimit të saj, edhe përkundër faktit tjetër, tashmë të njohur, si prijëse për shumë vite rresht në anketat e organizatave të dëshmuara profesionale për besueshmëri qytetare, ka vazhduar me zhvillimin e politikës bashkëkohore të NATO-s, pra me politikën e ndërtimit të integritetit. Politika e ndërtimit të integritetit u miratua në Samitin e NATO-s në Varshavë në vitin 2016 dhe mbulon strukturat civile dhe ushtarake të kësaj organizate¹. Kjo politikë, edhe në këtë edicion, do të vazhdojë të jetë në funksion të fuqizimit të vlerës së integritetit si normë e rëndësishme në procesin aktual të transformimit dhe objektivit strategjik për integrim në strukturat euroatlantike.

Plani i Integritetit (2019-2022) (më tutje “Plani”) paraqet dokumentin parimor të Ministrisë së Mbrojtjes (MM) me qëllim të reduktimit dhe eliminimit të rreziqeve të mundshme korruptuese në insti-

1 NATO Building Integrity Policy, Endorsed by the Heads of State and Government at the NATO Summit in Ēarsaē, 8–9 July 2016.

tucion. Dokumenti është vazhdimësi e Planit të parë të Integritetit (2016-2018)², në përputhje të plotë me bazën ekzistuese ligjore të Kosovës, e cila promovon qeverisjen e mirë dhe parimin e meritës në menaxhimin e burimeve njerëzore e materiale si dhe shpenzimet e parasë publike. Ky Plan, gjithashtu është në përputhje me Strategjinë Kombëtare Kundër Korrupsionit (2019-2022) si në aspektin konceptual gjithashtu edhe atë përmbajtësor në fushat e përgjithshme. Plani vijon të marrë plotësisht në konsideratë standardet ndërkombëtare juridike, të cilat Kosova i ka miratuar në formë të njëanshme, pavarësisht se shteti ende nuk është pjesë e disa organizatave ndërkombëtare siç janë: Organizata e Kombeve të Bashkuara (KB), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Këshilli i Evropës (KE) etj. Plani veçanërisht reflekton aspiratat e Kosovës për integrim në strukturat euroatlantike, sidomos në Bashkimin Evropian (BE) dhe në Aleancën Veri-Atlantike (NATO).

Ky Plan është në përputhje me objektivat e precizuara në letërkëmbimin mes Sekretarit të NATO-s dhe Kryeministrit të Kosovës në vitin 2016³, ku ndërveprimi i fuqizuar midis NATO-s dhe FSK-së ndër tjerash është i fokusuar edhe në çështjet e integritetit. Për më shumë, Programi i NATO-s për Ndërtimin e Integritetit (NI) paraqet një dokument bazë në të cilin institucioni duhet të harmonizojë përpjekjet me qëllim të minimizimit të rreziqeve korruptuese. Programi u krijua nga Këshilli i Partneritetit Euroatlantik në nëntor 2007 në kuadër të Planit të Veprimeve të Partneritetit për Ndërtimin e Institucioneve të Mbrojtjes (PAP-DIB), i cili ndihmon partnerët për të zhvilluar institucione të mbrojtjes efektive dhe efikase nën kontrollin civil dhe demokratik⁴. Mungesa e një bashkëpunimi kontraktual ndërmjet Kosovës dhe NATO-s nuk ndikon në përkushtimin e MM-së për jetësimin e parimeve dhe praktikave më të mira të NATO-s dhe anëtarëve të saj. MM-ja merr parasysh këshillat dhe sugjerimet për NI nga ana e Ekipit Këshillëdhënës dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT) në MM dhe në nivel dypalësh. Plani ka për qëllim që të bëjë përmirësime të mundshme brenda MM-së edhe pse, mund të thuhet se zbrazëtitat ligjore shpesh ndodhen jashtë sektorit dhe rrjedhimisht kanë të bëjnë me çështjet e kapaciteteve administrative dhe qeverisjes. Pra, dokumenti si i tillë nuk është i izoluar vetëm në MM, por është në përputhje me politikat kombëtare të kundër-korrupsionit si dhe me planet e ardhshme të integritetit në ministritë dhe agjencitë tjera të Kosovës. Në veçanti, ky Plan është në përputhje me rekomandimet e dala nga Strategjia Kombëtare Kundër Korrupsionit (2019-2022), ku MM ishte dhe është pjesë aktive e saj gjatë dizajnit dhe normalisht, do të jetë gjatë gjithë procesit të saj të zbatimit.

Ky version i Planit sikurse edhe ai i kaluari përbën një dokument të gjallë, i cili mund të përditësohet apo ndryshohet në të ardhmen varësisht nga trendi i zhvillimeve në politikat kombëtare në përgjithësi dhe politikat e mbrojtjes në veçanti. Zbatimi i tij do të pasohet me një fushatë të ngritjes së vetëdijes brenda dhe jashtë institucionit, në mënyrë që të sigurohet se integriteti është kuptuar në formë të drejtë dhe rrjedhimisht është i pranuar, bazuar në kuptimin e saj gjithëpërfshirës. Për më shumë, Plani parasheh një mori të masave të ngritjes së kapaciteteve brenda institucionit, zbatimi i të cilave duhet të raportohet çdo gjashtë muaj. Afatet dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e Planit përcaktohen në Matricën e masave për zbatim, e cila është shtojcë e integruar brenda këtij dokumenti.

2 :http://rebirthmedia.com/cids/wp-content/uploads/2016/06/Integrity-plan-MKSF_2016.pdf

3 Raporti vjetor i punës ëe MFSK/FSK-së për vitin 2017 fq.18

4 NATO Building integrity - Integrity, Transparency and Accountability in the Defence and Security Related Sector, Neësletter#02 - December 2017

Shkalla e zbatimit të Planit të Integritetit (2016-2018)

Plani i Integritetit (2016-2018) ka qenë një ndër kornizat bazë të ngritjes së integritetit në mandatit e kaluar të Ministrisë. Si pjesë e zbatimit të tij, janë përdorur instrumente të ndryshme dhe është evidentuar një dinamikë e madhe e gjithë departamenteve në funksion të zbatimit të 24 masave të përcaktuara. Nga këto masa, 17 janë realizuar plotësisht, kurse 7 janë realizuar pjesërisht. Kjo përbën një sukses të madh institucional për faktin se një numër i masave kanë qenë mjaft komplekse, kurse disa kanë qenë të ndërlikdhura me veprimtari ndër-institucionale, pra jo gjithmonë të varura nga puna e Ministrisë së Mbrojtjes.

Bazuar në vlerësimin e periudhës trivjeçare të procesit të realizimit të masave dhe aktiviteteve të përcaktuara, është arritur nivel shumë i lartë i realizimit të pjesës më të madhe të aktiviteteve të planifikuara. Këto aktivitete konsistojnë në:

- Plotësim/ndryshimin e legjislacionit dhe procedurave të nevojshme në sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore me fokus në aktet/procedurat që mundësojnë fuqizimin e masave për parandalimin dhe eliminimin e konfliktit të interesit; përmirësimin e cilësisë së procesit të përzgjedhjes për rekrutim, arsimim, trajnim, emërim dhe avancime.
- Përmirësimin e cilësisë së procedurave dhe kuadrit në fushën e hartimit të kërkesave për blerje, përgatitjes së specifikimeve teknike të nevojshme dhe zhvillimit të procedurave të duhura ligjore të prokurimit dhe kontraktimit. Krahas këtij procesi janë bërë përmirësime të dukshme në sistemin e menaxhimit të kontratave, menaxhimin e përgjithshëm të aseteve dhe sistemeve funksionale në MFSK/FSK.
- Ndërgjegjësimi përmes fushatave informuese dhe trajnimeve, kurseve, seminareve, konferencave, vizitave studimore në vendet partnere në fushën e ndërtimit të integritetit kanë qenë sistematike në nivel të Ministrisë dhe Forcës.

Sfidat konkrete në funksion të zbatimit të masave ishin:

- Moshartimi i Rregullores mbi prokurimin për qëllime të mbrojtjes dhe të sigurisë nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila rregullon kushtet dhe procedurat e prokurimit për pajisje të veçanta nga industria e mbrojtjes. Mungesa e kësaj Rregulloreje e pamundësoi edhe nxjerrjen e Udhëzuesit të brendshëm për shpjegimin e procedurave prokuruese që derivojnë nga Rregullorja për procedurat me revokim të nenit 3 të Ligjit të Prokurimit Publik.
- Pamundësia e rekrutimit të zyrtarëve me njohuri profesionale nga fusha e industrisë së mbrojtjes me njohuri të gjuhës angleze dhe gjuhëve të tjera për të hulumtuar tregun ndërkombëtar;
- Pamundësia e rritjes së numrit të personelit në NJAB dhe Inspektoratit të Përgjithshëm për shkak të pamundësisë së rritjes së numrit të stafit si rrjedhojë e kufizimeve në ndryshimin e strukturës organizative.

Qëllimi

Qëllimi kryesor i planit të integritetit është të forcojë integritetin dhe kulturën kundërkorrupsion në MM dhe FSK. Ky qëllim synohet të realizohet duke identifikuar, analizuar dhe vlerësuar rreziqet si dhe duke planifikuar dhe trajtuar ato përmes masave dhe veprimeve adekuata.

Parimet

Plani bazohet në tri parime të përgjithshme:

- a) Domosdoshmëria për përkufizimin e objektivave në funksion të ndërtimit të integritetit;
- b) Nevoja për krijimin e një mjedisi institucional të bazuar në kontroll dhe llogaridhënie;
- c) Pranimi i integritetit si një pjesë e pandarë e qeverisjes së mirë në MM/FSK.

Duke përkufizuar objektivat dhe nënobjektivat, MM-ja pritet që të zbatojë një spektër të masave dhe veprimeve që kanë për qëllim zvogëlimin e dukurive të mundshme negative dhe rreziqeve korruptive. Këto masa dhe veprime derivojnë nga analizat dhe vlerësimet si dhe mbulojnë fusha konkrete brenda fushëveprimit të MM-së dhe FSK-së.

Duke krijuar një mjedis institucional për kontroll dhe llogaridhënie, do të krijoheshin parakushtet për vlerësimin e dukurive negative dhe adresimin e tyre nëpërmjet instrumenteve të kontrollit në funksion të parandalimit të aktiviteteve të mundshme korruptive e mashtruese.

Duke njohur integritetin si pjesë të pandarë të qeverisjes së mirë, dokumenti siguron përfshirjen e konceptit të integritetit brenda kornizës qeverisëse të MM-së. Rrjedhimisht, integriteti vazhdon së konsideruari si një normë e vendosur dhe e aplikuar në të gjitha nivelet e MM/FSK-së.

Metodologjia

Pika fillestare e Planit është pajtimi i përgjithshëm se zhvillimi i kornizës së politikave duhet të bazohet në një kuptueshmëri të problemeve dhe sfidave në fushat e funksionimit institucional. Në rastin e këtij dokumenti, problemet janë identifikuar, analizuar dhe vlerësuar nga kompetentët e fushave funksionale bazuar në një spektër të gjerë të analizave dhe vlerësimeve profesionale.

Gjetjet kryesore të analizave kanë identifikuar një vizion të qartë të Kosovës për integrim në BE dhe NATO. Kjo rrugë është manifestuar në procesin e zhvillimit të kornizës së mirë juridike në sferën e integritetit dhe mekanizmave të kontrollit të brendshëm, të cilat janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe në harmonizim me legjislacionin e BE-s (*acquis communautaire*). Përderisa mekanizmat tashmë janë të themeluara, megjithatë kapacitetet ekzistuese në shkallë vendi në luftimin e korrupsionit ende nuk janë në nivelin e duhur. Nevoja për mbështetjen e ndërtimit të integritetit dhe zvogëlimin të potencialit korruptues në institucione ka gjetur mbështetje të madhe.

Ekipi ka analizuar bazën ligjore e institucionale për kornizën e integritetit në Kosovë. Gjatë këtij procesi, ka qenë një konstatim i përbashkët se tanimë ekzistojnë njohuri lidhur me konceptin e integ-

ritetit. Gjatë procesit të zbatimit të planit të kaluar, një numër i madh i stafit të MM-së dhe FSK-së kanë përfituar nga trajnimet dhe fushata e organizuar në funksion të sensibilizimit lidhur me rreziqet korruptive.

Sipas standardeve ekzistuese ndërkombëtare, mungesa e integritetit paraqet një situatë në të cilën dukuritë korruptive rrezikojnë kapacitetet institucionale për të ushtruar funksione në mënyrë llogaridhënese e të paanshme. Konsiderohet se rreziku nga korrupsioni dhe abuzimi i autoritetit vjen sidomos në shprehje në situatat kur një pjesë e madhe e fuqisë vendimmarrëse është shumë e centralizuar dhe se vendimmarrja është jashtë kornizave të transparencës dhe llogaridhënies. Në të gjitha Ministrinë e Mbrojtjes të vendeve demokratike, mbizotërimi i korrupsionit dobëson performancën e institucioneve deri në atë masë sa rrezikon thellësisht gatishmërinë luftarake të institucioneve të mbrojtjes.

Gjatë fazës së hulumtimit dhe analizimit është vlerësuar korniza e integritetit në MM bazuar në një metodologji të paracaktuar, e cila u aplikua në nëntë shtete të Evropës Jug-Lindore⁵. Kjo metodologji bazohet në dhjetë parimet standarde të organizatave kredibile siç janë CIDS dhe Transparency International Defence⁶, e ato janë:

1. Veprimi sipas standardeve më të larta të etikës dhe integritetit;
2. Sigurimi i praktikës më të mirë të qeverisjes dhe mbikëqyrjes së programit kundër-korrupsion;
3. Përgjegjësia ndaj palëve të interesit përmes transparencës dhe raportimit publik;
4. Sigurimi që politikat dhe procedurat e burimeve njerëzore të mbështesin programin kundër-korrupsion;
5. Hartimi i programit kundër-korrupsion bazuar në vlerësimin e plotë të rrezikut;
6. Zbatimi i politikave dhe procedurave të detajuara për të luftuar rreziqet kryesore të korrupsionit;
7. Menaxhimi i marrëdhënieve me palët e treta për të siguruar që ata të kryejnë një standard kundër-korrupsionit ekuivalent me atë të institucioneve shtetërore;
8. Përdorimi i komunikimit dhe trajnimit për të futur programin kundër-korrupsion;
9. Sigurimi i këshillave të sigurta dhe të arritshme dhe kanaleve të sinjalizuesve (bilbilave);
10. Monitorimi, vlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i zbatimit të programit kundër-korrupsion.

5 DiFi, Defence against corruption: The risk of corruption in the defense sector of 9 countries in South East Europe, p.12

6 ANTI-CORRUPTION PRINCIPLES FOR STATE-OWNED ENTERPRISES, A multi-stakeholder initiative of Transparency International

Procesi i përpilimit

Në funksion të mbikëqyrjes dhe koordinimit sa më të mirë të procesit të hartimit të Planit, Ministri i Mbrojtjes themloi Grupin Këshillëdhënës (MM 44/01/2019), i cili përbëhet nga Sekretari i Përgjithshëm i MM-së, përfaqësues i CIDS dhe Udhëheqësi i Ekipit Këshillëdhënës të NATO-s (NALT). Grupi Këshillëdhënës ushtroi funksione këshilluese për nevojat e grupit punues teknik gjatë gjithë procesit.

Gjithashtu, në funksion të një procesi efektiv të hulumtimit, analizës, vlerësimit dhe realizimit të Planit, MM themloi grupin punues teknik që kishte për detyrë dizajnimin përmbajtësor dhe teknik të Planit dhe Matricës zbatuese të tij. Grupi ishte formuar me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm (MM 66/04/2019), i përbërë nga anëtarë të MM/FSK-së, përfaqësues nga fusha e politikave e planeve, prokurimit dhe kontraktimit, personelit, logjistikës, financave, auditimit të brendshëm, zyrës ligjore dhe inspektoratit të FSK-së. Në grupin punues teknik janë përfshirë edhe nga një përfaqësues nga Ministria e Administratës Publike dhe Agjencia Kundër Korrupsionit si dhe dy këshilltarë të Ekipit Këshillëdhënës të NATO-s në MM. Të gjithë anëtarët kanë dhënë kontributin e çmuar në fushat e tyre përkatëse duke e bërë procesin shumë analitik e interaktiv.

Objektivat strategjike 2019-2022

Përcaktimi i objektivave ka rezultuar si produkt i procesit të sistemuar hulumtues, identifikues dhe vlerësues, të kombinuar me praktikatat bashkëkohore, përvojat tona si dhe ato të partnerëve tanë. Plani liston pesë objektiva të arritshëm, të cilët koncentrohen në fushat funksionale më të ndjeshme prej dukurive joetike, që përmes masave dhe veprimeve të përcaktuara duhet që të vazhdojnë të përmirësohen dhe avancohen edhe më shumë, si mënyrë e fuqizimit të kapaciteteve institucionale si dhe reduktimit e eliminimit të dukurive të mundshme negative.

Duke krijuar një mjedis institucional për kontroll dhe llogaridhënie, krijohen parakushtet për vlerësimin e rrezeve korruptive dhe adresimin e tyre nëpërmjet instrumenteve të kontrollit në funksion të parandalimit të aktiviteteve të mundshme korruptive e mashtruese.

Duke njohur integritetin si pjesë të pandarë të qeverisjes së mirë, dokumenti siguron përfshirjen e konceptit të integritetit brenda kornizës qeverisëse të MM/FSK-së. Rrjedhimisht, integriteti fillon të konsiderohet si një normë e vendosur dhe e aplikuar në të gjitha nivelet e MM/FSK-së.

Objektivat kryesorë të Planit të Integritetit (2019-2022) janë:

- 1. Avancimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore;**
- 2. Parandalimi i konfliktit të interesit;**
- 3. Avancimi i sistemit të prokurimit dhe kontraktimit;**
- 4. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve materiale, financiare dhe aseteve;**
- 5. Fuqizimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm.**

1. Avancimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore (MBNJ) përbën një sektor të një rëndësie të veçantë për vlerësimin e shkallës së fuqizimit të vlerave dhe standardeve profesionale dhe vlerave etike, ndër të cilat është edhe integriteti. Aplikimi i parimit të meritës në procesin e rekrutimit dhe gradimit të personelit e forcon integritetin në sistemin e MBNJ. Parimi i meritës nënkupton që emërimet duhet të bëhen në baza të paanshme dhe bazuar në procedura korrekte e të hapura dhe në përputhje me vlerësimin e nivelit të kompetencës për ta ushtruar atë detyrë.

MM/FSK-ja ka bërë progres të dukshëm në zhvillimin e politikave të avancuara të MBNJ-së, në pozitë civile dhe ato ushtarake. Megjithatë, MBNJ-ja duhet të fuqizojë tutje mekanizmat si një formë e eliminimit të elementeve eventuale të patronazhit e politizimit, gjë që rrezikon përpjekjet për ngritjen e integritetit në MBNJ. Nevojitet ndërtimi i sistemit efikas të vlerësimit të performancës, rekrutimin e bazuar në meritë qoftë për personelin e uniformuar, qoftë për atë civil, si dhe kërkohet ngritja e transparencës në procesin e gradimit.

Avancimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore si objektiv strategjik përfshin nënobjektivat, masat dhe veprimet si në vijim:

- 1.1. *Promovimi i integritetit dhe përgjegjësisë i të gjithë zyrtarëve në MM* - Integriteti si vlerë dhe standard institucional vlerësohet lart në të gjitha segmentet organizative dhe funksionale të MM-së dhe FSK-së. Ai është përcaktuar edhe si dispozitë e veçantë në Kodin e Etikës së MM-së dhe FSK-së. Përkundër faktit se integriteti trajtohet dhe respektohet si normë standarde, kërkohet një angazhim më i madh në funksion të sensibilizimit të të gjithë zyrtarët e MM-së dhe FSK-së nëpërmjet instrumenteve të ndryshme siç janë: ligjërata, trajnime, seminare (punëtori), konferenca, materiale të shkruara dhe elektronike etj.
- 1.2. *Rritja e transparencës në procesin e rekrutimit dhe avancimit në detyrë përmes evidentimit dhe aplikimit të teknologjisë*- Gjatë procesit të rekrutimit dhe avancimit të stafit, Komisioni i rekrutimit, i cili zhvillon procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve, do të kujdeset të mbajë raport me shkrim nga procesi i rekrutimit deri në fazën përfundimtare të përzgjedhjes. Komisioni intervistues i cili zhvillon intervistat me gojë do të kujdeset të mbajë shënimet me komente në formularët e vlerësimeve nga procesi i intervistimit. Në fund të intervistave anëtarët e Komisionit nënshkruajnë formularët e vlerësimit dhe hartojnë raportin përfundimtar.

MM/FSK-ja do të sigurojë kushtet për incizim të digjitalizuar të hapësirave ku zhvillohen proceset e rekrutimit dhe gradimit në nivel të bordeve/komisioneve testuese, intervistuese dhe përzgjedhëse për personelin ushtarak dhe civil. Qëllimi i kësaj metodologjie është promovimi i meritokracisë dhe forcimi i sundimit të ligjit në proceset e rekrutimit, përzgjedhjes dhe promovimit.

- 1.3. *Rritja e efikasitetit përmes regjenerimit të aftësive dhe kapaciteteve profesionale* - Ky proces aplikohet për pozitat ushtarake përmes praktikës së rrotacionit dhe transferimit për pozita të vlerësuara për këtë praktikë. Sipas dispozitave të Rregullores për Zhvillimin e Karrierës së Pjesëtarëve të FSK-së, pjesëtari i FSK-së emërohet në pozita të ndryshme me qëllim të përfitimit profesional nga shumëllojshmëria e detyrave, në përputhje me kapacitetet dhe kualifikimet e tij/saj. Shërbimi në pozita të ndryshme krijon mundësi zhvillimore, si për FSK-në, ashtu edhe për pjesëtarët. Po ashtu, e njëjta praktikë e rrotacionit synohet në disa pozita civile, sidomos në fushat e gjera të prokurimit, financave, logjistikës dhe burimeve njerëzore. Këto fusha mund të reflektojnë rreziqe për integritetin institucional.
- 1.4. *Minimizimi i marrëveshjeve për shërbime të veçanta* – MM/FSK inkurajohet që të minimizojë marrëveshje për Shërbime të Veçanta apo Kontrata të Punës për Detyra Specifike - (e njohur më parë si Kontratë mbi Vepër). MM/FSK-ja, përjashtimisht, mund të përdorë marrëveshje/kontrata të tilla vetëm për detyra specifike që nuk mund të mbulohen nga strukturat e saj, ndërsa kohëzgjatja duhet të përcaktohet bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- 1.5. *Procesi i ndërrimit të anëtarëve të bordeve të rekrutimit dhe gradimit*- Aplikimi i praktikës së ndërrimit periodik të përbërjeve të bordeve të rekrutimit dhe gradimit në MM/FSK është me fokus në emërimin e personelit profesional për fushat ekuivalente. Në funksion të efikasitetit sa më të mirë, do të vazhdojë praktika e ndërrimit të anëtarëve të Bordit si dhe zhvillimit të trajnimeve paraprake për stafin e bordeve përkatëse në fushën e rekrutimit dhe gradimit.
- 1.6. *Rishikimi i mekanizmave për raportimin e korrupsionit, duke siguruar konfidencialitetin në shqyrtimin e ankesave të denoncuesve*

Me qëllim të ofrimit të mundësisë për të shprehur të drejtën e ankesave në kushte të anonimitetit, në Ministri dhe në të gjitha objektet e FSK-së, do të krijohen kutitë e ankesave për t'ua mundësuar zyrtarëve/pjesëtarëve të të gjitha niveleve të shprehin ankesat/raportimet për rastet eventuale të korrupsionit në njësinë e tyre. Për shqyrtimin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi do të caktohen komisionet e veçanta që do të merren me shqyrtimin e ankesave dhe raportimeve eventuale për dukuri korruptive në MM/FSK. Ky proces do të jetë i strukturuar dhe komisioni përkatës do të evidentojë, të trajtojë dhe të raportojë ankesat eventuale të dukurive përkatëse me qëllim të parandalimit dhe luftimit të dukurive negative si dhe ruajtjen e konfidencialitetit të ankuesve.

2. Parandalimi i konfliktit të interesit

Konflikti i interesit nënkupton gjendjen e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit/ushtarakut, kur ai/ajo ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij/saj gjatë ushtrimit të funksionit publik. Për këtë shkak, ndër masat e nevojshme për parandalimin e konfliktit të interesit janë paraparë:

- 2.1 *Deklarimi i tërheqjes në rast të konfliktit të interesit* – konsiston në fuqizimin e procedurave për deklarimin e tërheqjes në rast të konfliktit të interesit. Praktika mund të njohë raste të ndryshme të implikimit, me apo pa dashje, në rastet e konfliktit të interesit. Pavarësisht se legjislacioni aktual i rregullon në masë të madhe rastet e konfliktit të interesit, institucioni ynë është i përkushtuar në fuqizimin e mekanizmave për parandalimin dhe shmangien e rasteve eventuale. Më konkretisht, do të kemi rishikimin e dispozitave relevante të Kodit të Etikës që aplikohet në MM/FSK për deklarimin e tërheqjes në rast të konfliktit të interesit, i cili akt do të harmonizohet me legjislacionin e fushës dhe në përputhje me specifikat e misionit mbrojtës.
- 2.2 *Rishikimi i akteve normative për çështjet e punësimit dytësor* - Punësim dytësor nënkupton çfarëdo punësimi, angazhimi apo aktiviteti tjetër të rregullt apo të kohëpaskohshëm jashtë institucionit, me pagesë apo pa pagesë. Zyrtarët e MM/ Pjesëtarët aktivë të FSK-së nuk mund të angazhohen në punësim tjetër dytësor jashtë institucionit, që pengon apo mund të pengojë kryerjen e detyrave të tij dhe që cenon në çfarëdo mënyre realizimin e objektivave të institucionit. Punësimi dytësor nuk do të lejohet nëse mund të përbëjë konflikt interesi faktik apo të dukshëm ndërmjet detyrave zyrtare, interesave private apo financiare të pjesëtarit aktiv, apo të ndikojë negativisht në çfarëdo mënyre në aftësinë e pjesëtarit në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të tij. Për këtë arsye, ndër masat e parapara është edhe fuqizimi i procedurave për çështjet e punësimit dytësor, respektivisht rishikimi i Rregullores për Punësimin Dytësor në MM/FSK për ndalimin në punësimin dytësor dhe çështjeve të punësimeve dytësore në përputhje me misionin mbrojtës. Me qëllim të mbrojtjes së interesave të institucionit dhe eliminimit të rasteve të përdorimit dhe keqpërdorimit të njohurive profesionale (*know how*), dhe duke u bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 04/I-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, do të bëhet ngritja e procedurave për eliminimin e keqpërdorimit të njohurive profesionale (*know how*) për personelin ushtarak dhe civil të MM/FSK për periudhën kohore të angazhimit/punësimit të tyre pas lirit nga detyra në rastet kur kemi konflikt interesi.
- 2.3 *Informimi dhe vetëdijesimi rreth parandalimit të konfliktit të interesit*- Krahas këtyre masave, ndër të tjera janë paraparë edhe fushata informimi dhe vetëdijesimi rreth parandalimit të konfliktit të interesit, punësimit dytësor dhe angazhimit/punësimit pas lirit nga detyra. Fushata përkatëse do të organizohet dhe realizohet nga instruktorët, të cilët do të zhvillohen përmes procesit të ngritjes së kapaciteteve profesionale në fushat përkatëse.

3. Avancimi i sistemit të prokurimit dhe kontraktimit

Me avancimin e sistemit të prokurimit dhe kontraktimit do të sigurohet integriteti dhe përgjegjësia e zyrtarëve publikë, nëpunësve civilë dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohen me jodiskriminim dhe me një shkallë sa më të lartë të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe ligjore.

- 3.1 *Përmirësimi dhe forcimi i sistemit të hartimit të kërkesave të prokurimit në MM/FSK - MM/FSK në përputhje me ligjin e prokurimit publik në fuqi, përdor edhe sistemin elektronik i cili garanton një proces transparent dhe siguron kushtet për një konkurrim të hapur dhe të paanshëm ndërmjet operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Në këtë sistem kryhen në mënyrë elektronike të gjitha procedurat e prokurimit publik, përfshirë prokurimet me vlerë të vogël, si dhe faza e parë e procedurave prokuruese, sipas parashikimeve legjislative përkatëse. Krahas këtij sistemi, MM/FSK është në proces të prokurimit të sistemit digjital të ciklit të procedurave të prokurimit përmes Sistemit intern të Menaxhimit të Informacionit (SIM), i cili do të mundësojë ngritjen e cilësisë, racionalitetit dhe ruajtjes së konfidencialitetit të sistemit të blerjeve të sistemeve të armatimit dhe pajisjeve të tyre. Për shkak të rëndësisë së këtij sistemi kërkohet edhe masat adekuate në funksion të ruajtjes së këtij sistemi nga rreziqet e mundshme.*
- 3.2 *Fuqizimi i sistemit të hulumtimit të tregut - Mënyrat dhe metodat e aplikimit të hulumtimit të tregut, në mënyrë që inkuadrimi në ato tregje të jetë sa më i lehtë, kërkon ekspertë me përvojë në analizimin e tregut rajonal, kontinental dhe global të sistemeve, projekteve e programeve të industrisë së mbrojtjes, duke njohur politikat e mbrojtjes dhe sigurisë si dhe doktrinat ushtarake që aplikohen aktualisht, si dhe strategjitë afatgjate të sigurisë, mbrojtjes dhe atyre tipike ushtarake. Për këtë arsye kërkohet edhe zhvillimi profesional i zyrtarëve/oficerëve për hulumtimin e tregut për qëllime të mbrojtjes dhe sigurisë në mënyrë që sistemet e armatimit, pajisjeve dhe shërbimeve të jenë maksimalisht funksionale në përmbushjen e misionit kushtetues dhe detyrave ligjore si dhe të jenë me kosto minimale financiare.*
- 3.3 *Përmirësimi i procesit të menaxhimit të kontratave – konsiston kryesisht në fuqizimin e kapaciteteve dhe ngritjes së kontrollit/monitorimit në fushën e menaxhimit të kontratave. Menaxhimi i kontratës nënkupton hapat që i mundësojnë MM-së si Autoritet Kontraktues të përmbushë detyrimet brenda kontratës, në mënyrë që të arrijë objektivat e përcaktuara nga kontrata. Pra, të marrë produktet që ka planifikuar dhe ofertuar me çmimin që e ka përcaktuar. Për t'u siguruar në kualitetin sipas kushteve të kontratës, MM/FSK synon procesin e suksesshëm të menaxhimit të kontratave përmes vetëdijesimit të menaxherëve të kontratave për rolin dhe përgjegjësitë e tyre. Komisionet për pranime teknike në fushën e infrastrukturës të sigurojnë Autoritetin Kontraktues nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në kontratë, duke përfshirë të gjitha kushtet e tjera të kontratës.*

4. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve materiale, financiare dhe aseteve

Përmes menaxhimit të duhur të burimeve materiale, financiare dhe aseteve, si një proces i strukturuar vendimmarrjeje nga MM dhe FSK, synohet të maksimizohet sigurimi sasior dhe cilësor i furnizimeve dhe shërbimeve nga to, ndërkohë, duke synuar minimizimin e kostos dhe rreziqeve eventuale korruptive përgjatë gjithë jetës së përdorimit të këtyre burimeve dhe aseteve.

- 4.1. *Fuqizimi i planifikimit dhe menaxhimit logjistik financiar* - Planifikimi i fondeve dhe përgatitja e kërkesave teknike dhe funksionale vazhdon të mbetet synim në funksion të menaxhimit efikas të mbështetjes logjistike. Për përmirësimin e menaxhimit të aseteve do të rishikohen të gjitha aktet normative dhe procedurale të menaxhimit të aseteve, duke synuar praktikatat dhe standardet më bashkëkohore të sistemit përkatës.
- 4.2. *Analizimi i projekteve (kërkesave) dhe përgatitja e specifikacioneve teknike* - Me qëllim të ngritjes së cilësisë së furnizimeve, shërbimeve dhe punëve ndërtimore të kontraktuara, do të themelohen komisionet e ekspertëve për të vlerësuar kërkesat në aspektin e planifikimit, hulumtimin të tregut si dhe hartimit të specifikacioneve teknike dhe funksionale. Aktiviteti i këtyre komisioneve do të rezultojë në vlerësimet më të sakta në mes çmimeve të planifikuara dhe atyre që ofrohen në treg, si dhe zvogëlimi i paqartësive teknike të kërkesat për pajisjet apo shërbimet e kërkuara me qëllim zvogëlimin e riskut për dështimin e projekteve.
- 4.3. *Përmirësimi i menaxhimit të aseteve* - Një ndër masat konkrete është rishikimi dhe plotësimi i Udhëzuesit për menaxhimin e aseteve (pasurisë) me fokus në rishikimin e procedurave të evidentimit si dhe përgjegjësitë e realizimit të detyrave. Menaxhimi i aseteve dhe flotës duhet të bëhet nëpërmjet evidentimit dhe krijimit të një sistemi më të mirë të llogaridhënies. Udhëzuesi do të duhej të përfshinte aspektet e digjitalizimit të evidentimit gjatë procesit të mirëmbajtjes së pajisjes si dhe monitorimit vizual nëpërmjet kamerave.

5. Fuqizimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm

Konsolidimi i një sistemi efektiv të qeverisjes së mirë dhe të kontrollit të brendshëm është thelbësor për një avancim të qëndrueshëm dhe përmirësime afatgjata të mekanizmave institucionale. Për këtë arsye MM angazhohet vazhdimisht për të forcuar struktura të tilla. Për t'iu përgjigjur sfidave dhe kërkesave të reja, menaxhmenti dhe administrata kërkohet të fuqizojnë edhe më tej kapacitetet e mekanizmave të kontrollit të brendshëm të cilat mbulojnë të gjitha aktivitetet e MM dhe FSK-së. Praktikë bashkëkohore në zhvillimin e auditimit të brendshëm, si një mekanizëm i qeverisjes së mirë institucionale, reflektohen në përcaktimin e masave dhe veprimeve adekuata në lidhje me reduktimin dhe eliminimin e rreziqeve të ardhshme potenciale dhe menaxhimin e rreziqeve.

5.1. *Fuqizimi i kontrollit të brendshëm* – Njësia e Auditimit të Brendshëm e MM-së dhe Inspektorati i FSK-së kanë përgjegjësi për të evidentuar sistemin e kontrollit të brendshëm si dhe raportimin e mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi.

5.1.1. *Realizimi i auditimeve dhe inspektimeve ad-hoc me vendim të Ministrit në fushën e integritetit* - Masa të efektshme do të vazhdojnë të jenë edhe realizimi i auditimeve dhe inspektimeve ad-hoc në fushën e integritetit me vendim të Ministrit. Në fund të proceseve do të hartohen raportet për aktivitetet e audituara dhe inspektuara në fushën e integritetit nga NJAB dhe Inspektorati i FSK-së. Për gjetjet e mundshme nxirren rekomandimet profesionale për subjektet e audituara dhe inspektuara, nga të cilat kërkohet zbatimi i tyre në afatet e përcaktuara kohore periodike.

5.2.1. *Menaxhimi i Rrezikut* - nënkupton identifikimin, analizën dhe vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni. Procesi i vendosjes së objektivave në të gjitha njësitë e MM/FSK-së përfshin një përshkrim të objektivave në nivel strategjik dhe operacional, që do të jetë bazë për përcaktimin e nivelit të rrezikut të njësive organizative në nivel të MM dhe FSK-së. Përgjegjësit e procesit janë përgjegjës për monitorimin e objektivave të proceseve të punës dhe menaxhimin e rreziqeve më të rëndësishme që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave. Misioni ushtarak i FSK-së determinon nevojën që MM të rishikojë Udhëzuesin e brendshëm për menaxhimin e rreziqeve, dhe përshtatjen e tij me specifikat e sistemit menaxhues, administrativ dhe funksional, si dhe fushëveprimin specifik sektorial të MM-së dhe FSK-së.

Procesi i zbatimit të planit të integritetit

Pas realizimit të pjesës konceptuale dhe asaj planifikuese, me përcaktimin e objektivave strategjikë, janë përcaktuar edhe instrumentet zbatues të tyre në formë masash dhe aktiviteteve konkrete, që së bashku përbëjnë Planin e veprimit të quajtur Matrica e masave dhe aktiviteteve për zbatimin e planit të veprimit. Kjo matricë është hartuar në mënyrë të qartë dhe të saktë, ku të gjithë aktorët e përfshirë, qoftë si përgjegjës kryesorë, apo si bashkëpunues në zbatim, janë të vetëdijshëm për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Procesi i zbatimit të matricës përkatëse do të monitorohet dhe vlerësohet në mënyrë sistematike si dhe do të raportohet rregullisht çdo 6 muaj në Departamentin për Planifikim dhe Vlerësim në MM. Për shkak të ndryshimit të trendeve të përgjithshme menaxhuese e administrative të institucioneve shtetërore, dhe në veçanti politikave të mbrojtjes, mund të shfaqet nevoja për rishikimin e Matricës së zbatimit të planit të integritetit me plotësime/ndryshime eventuale. Ky proces rekomandohet të bëhet gjatë vlerësimit vjetor në çdo fundvit pas raportimit për progresin e zbatimit. Ministri i Mbrojtjes dhe Zyrtares Kryesor Administrativ në MM duhet të caktojë një komision permanent që do të bëjë monitorimin, analizën dhe vlerësimin e shkallës së realizimit të masave dhe aktiviteteve të vendosura në matricë. Të dhënat nga ky proces, ky komision do t'i raportojë në mënyrë narrative, me metoda statistikore, në mënyrë tabelore dhe me pasqyra grafike. Komisioni, paralelisht këtij procesi, do të jetë përgjegjës edhe për procedimin me praktikën e njëjtë për aktivitete, nën përgjegjësinë e autoritetit të MM-së, të Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit (2019-2022).

Cilësinë dhe vërtetësinë e të dhënave të raporteve përkatëse mund ta bëjë Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), autoritetet e përcaktuara nga niveli ndërqeveritar për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të planeve të integritetit (nëse themelohet si mekanizëm i veçantë nga MAP) ose Divizioni për Hetim dhe Strategji i AKK-së, si bartësi kryesor dhe përgjegjës për arritjen e objektivave të Strategjisë Shtetërore Kundër Korrupsionit (2019-2022).

Matrica e masave dhe aktiviteteve për zbatimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes (2019-2022)

OBJEKTIVI-I AVANCIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE										
Nr	Nënobjekтиви	Masat	Aktivitetet	Periudha kohore	Përg-jegjësit kryesorë	Në bash-këpunim	Treguesit e suksesit/ raporti	Vlerësimi		Vërejtje
								I realizuar	Pjesërisht i realizuar	I përcaktuar
	1.1 Promovimi i integritetit, dhe përgjegjësisë i të gjithë zyrtarëve në MM	1.1.1 Organizimi i trajnimeve për integritet	1. Angazhimi për pjesëmarrje në trajnimet për promovimin e integritetit dhe vetëdijesimi në fushatën kundër korrupsionit	Në vazh-dimësi	DBNJ	AKK IKAP CIDS				
OBJEKTIVI-I	1.2 Rritja e trans-parencës në proces-in e rekrutimit dhe avancimit në detyrë përmes evidentimit dhe aplikimit të teknologjisë	1.3.1 Garantimi i qasjes së barabartë në rekrutimin dhe avancimin e stafit në pozita.	1. Gjatë procesit të rekrutimit dhe avancimit të stafit, komisioni i rekrutimit dhe avancimit, i cili zhvillon procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve, do kujdeset të mbajë raport me shkrim nga procesi deri në fazën përfundimtare të përzgjedhjes. Komisioni i cili zhvillon intervistat me gojë do kujdeset të mbajë shënimet me komente në formu-larët e vlerësimeve nga procesi i intervistës. Në fund të intervistave anëtarët e komisionit nënshkruajnë formularët e vlerësimit dhe hartojnë raportin përfundimtar. MM/FSK do të sigurojnë kushtet për incizimin e digjitalizuar të hapësirave ku zhvillohen proceset e rekrutimit dhe gradimit në nivel të bordeve/komi-sioneve testuese, intervistuese dhe përzgjedhëse për personelin ushtarak dhe civil.	Në vazh-dimësi	DBNJ	ZDNJ D-LIGJ MAP, KPMK				

OBJEKTIVI-I	1.3 Rritja e efikasitetit përmes regjenerimit të aftësive dhe kapaciteteve profesionale	1.4.1 Aplikimi i praktikës së rotacionit dhe transferimit për pozita të vlerësuara për këtë praktikë	1.Rekomandimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm për pozitat që kërkohet rotacioni dhe transferimi në bazë të parimit të meritës dhe nivelit të kompetencës	Çdo fund vit	DBNJ	MM SHPFISK				
		1.4.2 Minimizimi i Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta	1.Minimizimi i rasteve të mbulimit me personel më kontratat për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta. Aplikimi mund të bëhet vetëm për fushat e nevojshme dhe specifike, që nuk mbulohen nga struktura e MM/FISK dhe mbulimi i tyre bëhet me procedurat e papapara ligjore.	Në vazhdimësi	DBNJ	G1SHPFISK dhe Njësitë Organizative MM				
		1.4.3 Procesi i ndërrimit të anëtarëve të bordeve të rekrutimit dhe gradimit	1.Aplikimi i praktikës së ndërrimit periodik të përbërjeve të bordeve në MM/FISK të rekrutimit dhe gradimit me fokus në emërimin e personelit profesional për fushat ekuivalente	Në vazhdimësi	DBNJ	G1SHPFISK, Komisioni i veçantë				
			2.Zhvillimi i trajnimit paraprak për stafin e bordeve përkatëse në fushën e rekrutimit dhe gradimit	Në vazhdimësi	DBNJ	G1SHPFISK, Komisioni i veçantë				
	1.4 Rishikimi i mekanizmave për raportimin e korrupsionit, duke siguruar konfidencialitetin në shqyrtimin e ankesave të denoncuesve	1.4.1 Krijimi i kutive të ankesave për t'ua mundësuar zyrtarëve të të gjitha niveleve të shprehin ankesat/raportimet për korrupsionin në institucionin e tyre	1.Caktimi i komisioneve që do të merren me ankesat/raportimet për korrupsionin në institucione	Në vazhdimësi	SEKR-MM KOMF-SK-FSK					
		1.4.2 Evidentimi i ankesave	1.Trajtimi dhe raportimi ankesave të korrupsionit me qëllim të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit dhe dukurive negative si dhe ruajtja e konfidencialitetit të ankesave	Në vazhdimësi	DBNJ					

OBJEKTIVI II											
PARANDALIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT											
Nr	Nënobjekтиви	Masat	Aktivitetet	Periudha kohore	Përgjegjësit kryesorë	Në bashkëpunim	Treguesit e suksesit/ raporti	Vlerësimi			Vërejtje
								I realizuar	Pjesërisht i realizuar	I parrealizuar	
	2.1 Deklarimi i tërheqjes në rast të konfliktit të interesit	2.1.1 Fuqizimi i procedurave për deklarimin e tërheqjes në rast të konfliktit të interesit	1.Rishikimi i procedurës (Kodi i Etikës) i aplikueshëm në MM/FSK për deklarimin e tërheqjes në rast të konfliktit të interesit në MM/FSK e harmonizuar me legjislacionin relevant.	Dhjetor 2019	DBNJ	DLIGJ SHPSK AKK, NALT					
	2.2 Rishikimi i akteve normative për çështjet e punësimit dytësor	2.2.1 Fuqizimi i procedurave për çështjet e punësimit dytësor	1.Rishikimi i procedurës (Rregullores për Punësimin Dytësor në FSK) për ndalimin në punësimin dytësor dhe çështjeve të punësimeve dytësore si dhe minimizimi i tyre vetëm për ato raste kur nuk reflektojnë konflikt interesi.si dhe ngritja e procedurave për eliminimin e keqpërdorimit të njohurive profesionale(know how)	Dhjetor 2019	DBNJ	DBNJ, DLIGJ SHPSK AKK, NALT					
	2.3 Informimi dhe vetëdijësimi rreth parandalimit te konfliktit te interesit	2.3.1 Ngritja e kapaciteteve profesionale në fushën e parandalimit te konfliktit te interesit	1.Zhvillimi i trajnimeve në fushën e parandalimit të konfliktit të interesit	Në vazhdimësi	DBNJ	DLIGJ, AKK, IKAP, MAP, CIDS	MM,AKK, CIDS				

OBJEKTIVI-III AVANCIMI I SISTEMIT TË PROKURIMIT DHE KONTRAKTIMIT									
Nr	Nënbjektivi	Masat	Aktivitetet	Periudha kohore	Përgjegjësit kryesorë	Në bashkëpunim	Treguesit e suksesit/raporti	Vlerësimi	Vërejtje
	3.1 Përmirësimi i prokurimit publik dhe kontraktimit	3.1.2 Përmirësimi dhe forcimi i sistemit të hartimit të kërkesave të prokurimit në MM/FSK	1.Zhvillimi i sistemit digjital të ciklit të procedurave të prokurimit përmes Sistemit të Menaxhimit të Informacionit(SIM)	Mars 2019 – Dhjetor 2022	DSKI	DPROK DFIN, DLOG, G4/8 SHPF-SK MM, MAP		I realizuar Pjesërisht i realizuar I parrealizuar	
OBJEKTIVI III									
		3.1.3 Fuqizimi i sistemit të hulumtimit të tregut	1.Rekrutimi dhe zhvillimi profesional i zyrtarëve/oficerëve për hulumtimin e tregut për qëllime të mbrojtjes dhe sigurisë	2019- Dhjetor 2022	DBNJ	DLOG DPROK MAP NALT			
		3.1.4 Zhvillimi i procedurave të prokurimit sipas rregullores për qëllime të mbrojtjes dhe sigurisë (neni 3 përjashtimet e Ligjit të Prokurimit Publik)	1.Klasifikimi i projekteve duke u mbështetur në qëllimin e rregullores me një analizë dhe vlerësim nga komisionet përkatëse që justifikojnë përdorimin e procedurave të prokurimit për qëllime të mbrojtjes dhe sigurisë	2020-2022	Ministri i MM	MM SHPF/SK			

OBJEKTIVI-III AVANCIMI I SISTEMIT TË PROKURIMIT DHE KONTRAKTIMIT										
Nr	Nënobjekti	Masat	Aktivitetet	Periudha kohore	Përgjegjësit kryesorë	Në bashkëpunim	Treguesit e suksesit/ raporti	Vlerësimi		
OBJEKTIVI III								I realizuar	Pjesërisht i realizuar	I parrealizuar
		3.1.5 Përmirësimi i procesit të menaxhimit të kontratave	1.Fuqizimi i kapaciteteve dhe ngritja e kontrollit/monitorimit në fushën e menaxhimit të kontratave	Në vazhdimësi	DPROK	DLOG, NJAB, INSP DFIN, NJMSHP, G4-SHPFSK,				
			2.Trajnimi i vazhdueshëm në fushën e menaxhimit të kontratave	Në vazhdimësi	DBNJ	DPROK NJAB KRPP NALT				
		3.1.6 Sigurimi i kualitetit sipas kushteve të kontratës.	1.Menaxherët e kontratave të sigurojnë që kontraktorët t’i përmbushin të gjitha obligimet e performancës sipas planit të menaxhimit të kontratave komfor LPP-se dhe të përgatisin një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës.	Në vazhdimësi	Menaxherët e Kontratës	Sekretari i Përgjithshëm DPROK				
		3.1.7 Emërimi i komisioneve për pranimë teknike	1.Komisionet për pranimë teknike të jenë ekspertë të fushave përkatëse dhe të sigurojnë autoritetin kontraktues nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në kontratë duke përfshirë të gjitha kushtet tjera të kontratës	Në vazhdimësi	SEKRE-TA-RI I PËRGJITHSHËM	MM/FSK				

OBJEKTIVI-IV PËRMIRËSIMI I SITEMIT TË MENAXHIMIT TË BURIMEVE MATERIALE, FINANCIARE DHE ASETETE										
Nr	Nënobjekti	Masat	Aktivitetet	Periudha kohore	Përgjegjësit kryesorë	Në bashkëpunim	Treguesit e suksesit/ raporti	Vlerësimi		
								I realizuar	Pjesërisht i realizuar	I përcaktuar
	4.1 Fuqizimi i planifikimit& menaxhimit material dhe financiar	4.1.1 Analizimi i projekteve (kërkesave) dhe përgatitja e kërkesave teknike	1.Themelimi i komisioneve të ekspertëve për të vlerësuar kërkesat, analizimin e kostove, hulumtimin e tregut si dhe specifikacionet teknike, me ç'rast synohet zvogëlimi i dallimit në mes çmimeve të planifikuara dhe atyre që ofrohen në treg, si dhe zvogëlimi i paqartësive teknike të kërkesat për pajisjen apo shërbimin e kërkuar me qëllim zvogëlimin e rrezikut për dështimin e projekteve.	Në vazhdimësi	DLOG	MM SHPFSK				
		4.1.2 Avancimi në përgatitjen e specifikacioneve teknike	1.Zhvillimi profesional për personelin të cilët përgatisin specifikacionin teknik	Në vazhdimësi	DBNJ DLOG	MM FSK IKAP NALT				
OBJEKTIVI-IV		4.1.3 Përmirësimi i menaxhimit të aseteve	1.Rishikimi i akteve normative dhe procedurale të menaxhimit të aseteve dhe ngritja e vazhdueshme profesionale e personelit (rishikimi dhe plotësimi i Udhëzuesit për menaxhimin e pasurisë. Ky udhëzues duhet të rishikohet të pjesa e procedurës së evidentimit si dhe përgjegjësitë e realizimit të detyrave)	Në vazhdimësi	DLOG, NJAB, INSP	DPROK/D-FIN/NJ/MSH-PG4-SHPF-SK/NALT				
			2.Zhvillimi i sistemit digjital të brendshëm për regjistrimin e pasurisë në mënyrë që të evitohet mundësia për regjistrimin e dyfishtë të pasurisë në SIMFK dhe E-pasuria	Mars 2019 – Dhjetor 2022	DSKI	DLOG DPROK DFIN NJMBMM G4SHPFSK				
		4.1.4 Përmirësimi i planifikimit dhe re-alizimit të buxhetit	1.Rishikimi i udhëzuesve për planifikim dhe ekzekutim të buxhetit	Janar 2020-Dhjetor 2020	DFIN	DLOG DPROK SHPFSK				

OBJEKTIVI-IV

OBJEKTIVI-V FUQIZIMI I MEKANIZMAVE TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM								
Nr	Nënobjekтиви	Masat	Aktivitetet	Periudha kohore	Përgjegjësit kryesorë	Në bashkëpunim	Treguesit e suksesit/raporti	Vlerësimi
								I realizuar Pjesërisht i realizuar I parealizuar
								Vërejtje
	5.1 Fuqizimi i kontrollit të brendshëm	5.1.1 Kryerja e auditimit ad – hoc me Vendim të Ministrit në fushën e integritetit	1.Raport për aktivitetet e audituara në fushën e integritetit nga NJAB 2.Zbatimi i rekomandimeve MM/FSK qe dalin nga NJAB për fushën e integritetit	Në vazhdimësi Në vazhdimësi	NJAB NJAB	MM MM/FSK		
		5.1.2.Inspektim sipas planit,si dhe inspektim pa paralajmërim, me Vendim të Ministrit dhe me kërkesë të Komandantit të FSK-së	1. Përgatitja dhe miratimi i Raportit ne fushën e zbatueshmërisë së planit të integritetit nga Inspektorati i FSK-së 2. Monitorimi mbi zbatueshmërinë e Rekomandimeve të dhëna nga INSP	Në vazhdimësi Në vazhdimësi	INSP INSP	MM/FSK MM/FSK		
	5.2 Forcimi i mekanizmave kundër-korrupsionit në MM	5.2.1 Identifikimi, analiza dhe vlerësimi i rrezeqeve nga korrupsioni	1.Identifikimi, analiza dhe vlerësimi i rrezeqeve nga korrupsioni në nivel të departamenteve	Në vazhdimësi	MM	DPROK DLOG DBNJ DFIN		



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO

MINISTRIA E MBROJTJES

MINISTARSTVO ODBRANE-MINISTRY OF DEFENSE